



QENDRA SHQIPTARE PER POPULLSINË DHE ZHVILLIMIN
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT



MANUAL PËR GAZETARËT **SHËNDETI SEKSUAL DHE RIPRODHUES**

PSE DUHET NJË UDHEZUES PËR GAZETARËT?

Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (QSHPZH) përmes këtij udhëzuesi synon të ndihmojë dhe orientojë mediat se si të raportojnë mbi tema të ndryshme lidhur me shëndetin seksual dhe riprodhues për t'i pajisur ato me mjetet e nevojshme për të komunikuar këto çështje në mënyrë efektive, etike dhe të saktë.


Në përbushje të misionit të tyre, sidomos gazetarët e rinj, kanë nevojë për trajnime, manuale për shëndetin seksual dhe riprodhues, njohuri mbi të drejtat e njeriut, për të kuptuar rëndësinë e trajtimin në publik të çështjeve të tillë, ndikimin në opinionin e gjerë, modelet e krijuara si dhe mundësia e një dritareje të hapur shprehjeje për të gjithë personat apo viktimat e problematikave dhe ngjarjeve që lidhen me shëndetin seksual dhe cënimin e tij.

*Ky udhëzues është hartuar në kuadër të projektit "Voucher initiative" me mbështetje të IPPF (International Planned Parenthood Federation) dhe ACPD (Albanian Center for Population and Development).



Si në shumë vende të tjera të **Europës**, edhe në **Shqipëri** marrëdhëniet gjinore karakterizohen nga problematika si pabarazia, shkeljet dhe diskriminimi dhe problematika të shëndetit dhe të drejtat e tyre seksuale riprodhuese.


Si në çdo sektor apo fushë tjetër, edhe në shëndetin seksual riprodhues ka ndryshime në terminologji t cilat duhet të reflektohen në mënyrë të sakt në artikuj kronika televizive. . Ndikimi në rrjetet sociale dhe platformat online kanë rëndësinë e tyre në jetën e secilit ndaj gazetarët duhet të jenë të kujdeshëm dhe të vetëdijshëm për ndjeshmérinë që kanë historitë personale që sjellin publikisht për të gjithë audiencat në media tradicionale dhe ato sociale.



Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (QSHPZH) në takimet e vazhdueshme me median përmes krijimit të një rrjeti me gazetarët profesionistë të çështjeve sociale dhe shëndetësisë është e vetëdijshme për rolin që kanë gazetarët dhe mediat në ndryshimin e të menduarit dhe qëndrimeve shoqërore dhe impaktit në publik.

Avokimi mediatik i **Qendrës Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillim** synon reduktimin e praktikave diskriminuese dhe inkurajimin e politikave dhe iniciativave që do t'u mundësojnë, kryesisht grave, mbështetjen për aksesin në shërbimet shëndetësore dhe për popullatën në tërësi si dhe informim sa më objektiv ndaj tematikave të tillë të ndjeshme.

*ACPD është OJF e akredituar nga IPPF në vitin 1993 dhe partnerë implementuese e UNFPA e orientuar drejt shërbimeve gjinekologjike.



Media vizive, e shkruar, online dhe platformat e tjera online janë mënyrat më të rëndësishme për të informuar popullsinë për shëndetin, avancimin e teknikave mjekësore, trajtimin me ndikimin e drejtpërdrejtë në mirëqenien e brezave të tanishëm dhe të ardhshëm.

Mediat në vete luajnë një rol kritik në sjelljen seksuale dhe në shëndetin riprodhues dhe debati publik në vete ndikon në politikat e shëndetit në tërsi. Këtu përfshihen qeveria, institucionet përgjegjëse, organizata që kanë në fokus çështjet sociale, ekspertë të shëndetit dhe opinioni publik në tërsi.

Manuali i gazetarëve që mbulojnë çështjet sociale për shëndetin seksual dhe riprodhues do të shërbejë si një udhëzues për median duke përfshirë shëndetin dhe mirëqenien në çështjet që lidhen me marrëdhëniet seksuale, shtatzënitë dhe lindjet, marrëdhëniet intime, abortet, martesat e hershme, sëmundjet seksualisht të transmetueshme, patologjitë e ndryshme etj.

ROLI I GAZETARËVE

Gazetarët e çështjeve sociale në kronikat televizive, artikujt, emisionet e tyre që trajtojnë çështjet e shëndetit seksual dhe riprodhues duhet të kenë në konsideratë kujdesin ndaj mos ekspozimit të viktimës; imazhe dhe të dhëna, detaje të panevojshme për opinionin e gjerë publik.

Gjithashtu gazetarët duhet të jenë të kujdeshëm në:

- **Përcjelljen e raportimeve dhe tematikave që janë më pak të ndeshura, që kanë nevojë për sensibilizim dhe analizë mirëfilli profesional.**
- **Monitorimin e progresit ose jo të qeverisë për politikat dhe përkrahjen sociale;**
- **Vendosjen e institucioneve apo organizatave të tjera para përgjegjësisë për premtimet e pa mbajtura, për mos-alokimin e fondeve në kategoritë që vërtetë kanë nevojë.**



FERTILITETI

Fertiliteti tek femrat është aftësia që një grua ka për të mbetur shtatzënë dhe lindur fëmijë në mënyrë natyrale.

Nëse një çift tenton për shtatzëni prej më shumë se 1 viti ose prej më shumë se 6 (gjashtë) muajsh por nuk ka rezultuar në një shtatëzani, në rast se gruaja është mbi 35 vjeç, atëherë kemi të bëjmë me Infertilitet.

Disa faktorë që ndikojnë në infertilitet janë patologjitetë të caktuara mjekësore, stili i jetesës, çrregullimet hormonale, konsumi i alkoolit etj.

INFERTILITETI TEK MESHKUJT

Infertiliteti tek meshkujt vjen si pasojë e problemeve që lidhen me parametrat e spermogramës (analiza e spermës).

Problemet që mund të shkaktojnë infertilitet tek meshkujt mund t'i ndajmë në dy veçori: në problemet që prekin prodhimin e spermës nga testikujt dhe në problemet që prekin transportin e spermës jashtë kanalit gjenital mashkullor.

SHËNIME DHE SUGJERIME PËR GAZETARËT

Terminologjia e shëndetit seksual dhe riprodhues është sa e gjerë por edhe specifike, profesionale etj. Gazetarët që mbulojnë çështjet e shëndetit riprodhues e gjejnë veten të limituar në identifikimin e problematikave, informacionin derisa krijojnë eksperiencën e nevojshme profesionale në këtë fushë. Manuali referon disa sugjerime për terminologjinë, konceptet dhe disa rekomandimeqë gazetarët duhet t'i kenë në konsideratë gjatë misionit të tyre.

- ✓ Përdorimin e termit “shkalla e fertilitetit” në vend të termit formal “norma totale e lindshmërisë” kur referohet numri i fëmijëve që ka një grua.
- ✓ Në artikuj sugjerohet përdorimi numër i plotë ose i përafërt pa presje dhjetore në statistikat referuese të kuptueshme për audiencën.

Shembull: Fertilitetit në Shqipëri gjatë vitit 2022 u ul në 1.21 fëmijë për grua në moshë riprodhimi, nga 1.32 që ishte më 2021. Kjo është rënia më e fortë që nga viti 2015 (INSTAT 2022, normat totale të fertilitetit).

- ✓ Në këtë rast rekomandohet që terminologjia për gazetarët në materialet e tyre të jetë një numër i plotë pa pikë dhjetore. Pra rreth 1 fëmijë për grua në vend të 1.21 fëmijë për grua. Kjo do e bënte më të qartë dhe të kuptueshëm për publikun.
- ✓ Mos i shprehni normat e lindshmërisë në përqindje.
- ✓ E rëndësishme është përfshija e opinionit dhe ekspertizës së mjekëve specialistë, kryesisht obstetër e gjinekologë në materialet tuaja mediatike. Do të ishte profesionalisht korekte nëse do të gjenit kohë për t'u konsultuar paraprakisht për çështjet e riprodhimit dhe planifikimit familjarë me ekspertë të shëndetit për artikujt dhe raportimet tuaja. ACPD është në dispozicion për konsulta me gazetarët e çështjeve sociale dhe ekspertëve më të mirë të fushës.

II

ULJA E MORTALITETIT

Asnjë simptomë dhe asnjë shenjë nuk mund të neglizhohet në shtatzëni pasi ato mund të jenë fatale për nënrat shtatzënë. Situata është më serioze sidomos ndaj nënave me aftësi të veçanta. Në këtë rast, planifikimi familjar zvogëlon rrezikun e vdekjes së nënës veçanërisht nga shtatzëni që janë të padëshiruara. Ndërsa çdo shtatzëni paraqet disa rreziqe për shëndetin, rreziqet janë më të larta për femrat që janë nën moshën 18 vjeçe.

Në zonat rurale dhe në vendet që janë në zhvillim shumë gra shtatzëna nuk marrin kujdesin që u nevojitet para, gjatë dhe pas lindjes sepse nuk ka shërbime në zonat ku jetojnë ose kur shërbimet ofrohen vetëm në sektorin jopublik që janë të vështira për t'u aksesuar nga msa e gjerë për shkak të kosotove.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) rekomandon që gratë shtatzëna të kenë të paktën katër vizita antenatale, duke filluar në tre muajt e parë të shtatzënisë.

SHËNIME DHE SUGJERIME PËR GAZETARËT

- ✓ Jepuni zë dhe hapësirën e duhur grave shtatzënë, nënave me aftësi të veçanta në zona të largëta, rurale apo atyre në bujqësi, grave të dhunuara apo viktima të trafikimit, shtatzënë ose jo.
- ✓ Zgjidhni terminologjinë e duhur, jo atë teknike sepse është e pakuptueshme për audiencën e thjeshtë.
- ✓ Në rastet ku ka ndjeshmëri të lartë emocionale si viktima të trafikimit apo gra të dhunuara shhangni të dhënat e plota të tyre.
- ✓ Paraqisni në historitë tuaja të publikimit edhe anën tjetër pozitive apo përpjekje që po bëhen nga institucioni, familja, vetë personat. Modelet pozitive janë po kaq të nevojshme në historinë tuaj të publikimit.
- ✓ Kur flisni për mortalitetin, përpinquni të përdorni sinonime të tillë si “humbi jetën”, “nuk arriti dot të jetonte” etj.
- ✓ Përdorini të dhënat krahasimore me vendet e rajonit, europës, botës. Të dhënat janë më të kuptueshëm kur krahasohen me vendet më të afërta.

III

HIV DHE AIDS

HIV është virusi i cili prek dhe dobëson sistemin imunitar të organizmit të njeriut duke e lënë atë të pambrojtur nga infekzionet dhe nga disa lloje kanceri.

ADIS - Faza më e avancuar e infekzionit **HIV**, i cili mund të zgjasë nga 2 deri në 15 vjet për t'u zhvilluar, në varësi të individit. **AIDS** është përcaktuar si zhvillimi i llojeve të ndryshme të kancerit, infeksioneve apo manifestimeve të tjera të rënda klinike.

HIV nuk është sinonim i **AIDS**. Një person i infektuar me virusin **HIV**, jo domosdoshmërish është i sëmurë me **AIDS**; ai mund të jetë i infektuar me virusin **HIV** por mund të mos jetë i sëmurë me **AIDS**.


SËMUNDJET E TJERA SEKSUALISHT TË TRANSMETUESHME

Infekzionet Seksualisht të Transmetueshme janë infeksione që transmetohen gjatë kontaktit seksual të pambrojtur, me dikë që është i infektuar. Këto infeksione shkaktohen nga viruse, bakterie dhe parazitë. Ato prekin si femrat ashtu edhe meshkujt.

Infekzionet Seksualisht të Trasmetueshme janë nga më të ndryshmet, nga ato që japidin vetëm një bezdi të lehtë deri tek ato me pasoja nga më seriozeta, nëse ato nuk trajtohen në kohë. Sot numërohen më tepër se 25 lloje infeksionesh seksualisht të transmetueshme dhe ndër më të shpeshtat janë **“Gonorreja, Sifilizi, Trikomansi, Myku, Hepatiti B, Herpes Gential, Aids”**.

SHËNIME DHE KËSHILLA PËR GAZETARËT

- ✓ Përtej scoop-it të një personi që dëshmon betejën e tij me **HIV dhe AIDS** apo sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, respektoni kërkesat për anonimat nga njerëzit që jetojnë me **HIV dhe AIDS**, dhe kujdes në raportimin e personave të infektuar.
- ✓ Shmangje ose kujdes të veçantë ndaj intervistimit të fëmijëve të infektuar me virusin **HIV**. Ata mund të janë viktima edhe të bullizimit apo keqtrajtimit të bashkëmoshatarëve të tyre.
- ✓ Referoni shembujt pozitiv, raste pacientësh të cilët ia kanë dalë mbanë, i janë kthyer normalitetit. Inkurajoni pacientët që falë edhe zhvillimit të teknikave mjekësore dhe shkencës, partnerët e infektuar mund të lindin dhe fëmijë të shëndetshëm dhe virusi është i izoluar.




IV **Aborti**

Aborti është ndërprerja e një shtatzënie me heqjen e një embrioni ose fetusit para se të mund të mbijetojë jashtë mitrës.

Aborti mund të jetë spontan ose klinik.

Aborti spontan është humbja jo e provokuar e shtatëzanisë para javës së 20- të saj.

Rreth 10-20% e shtatëzanive të identifikuara përfundojnë ne **abort spontan**, por numri i humbjeve spontane është më i madh, pasi pjesa më e madhe e shtatëzanive përfundojnë përpëra se vetë gruaja ta dijë që është shtatëzane. Shumica e aborteve ndodhin pasi fetusi nuk është i zhvilluar normalisht, dhe shpesh herë është vështirë të përcaktohet apo të gjendet shkaktari i vërtetë.



Aborti klinik është një mënyrë për të ndaluar shtatzënинë e hershme.

Pilulat e abortit të administruara nga mjeku gjinekolog janë dy:


Medikamenti i parë bllokon hormonin progesteron, ndërsa medikamenti tjetër ndihmon në kontraktimin e placentës duke bërë që embrioni të dalë në rrugë vaginale dhe shtatzënia të ndalohet.

Arsyet e kryerjes së **abortit** janë personale dhe mund të jetë zgjidhje për të përfunduar një shtatzëni të padëshiruar apo rastet e një gjendjeje mjekësore që e bën vazhdimin e një shtatzënie të rrezikshme për jetën.

Cilat janë llojet e aborteve në klinikë?

Aborti me aspiracion (i quajtur gjithashtu abort me vakum) është lloji më i zakonshëm i abortit në klinikë. Përdoren thithje dhe mjete mjekësore për të zbruzur mitrën. Zakonisht kjo procedurë kryhet deri rreth 14 javë pas periudhës së fundit menstruale.

Dilatimi dhe Evakuimi (D&E) është një tjetër lloj i abortit në klinikë që mund të bëhet më vonë në shtatzëni - zakonisht pasi kanë kaluar 16 javë ose më shumë nga periodat e fundit.



SHËNIME DHE SUGJERIME PËR GAZETARËT

- ✓ Reduktoni sa të jetë e mundur stereotipin që gratë kryejnë **abort** dhe se **aborti** është një procedurë normale për shtatëzani të padëshirueshme.
- ✓ Përdorni terma si "**shtatëzani e padëshirueshme**", "**ndërprerje e shtatëzanisë**"
- ✓ Respektoni kërkesën e një gruaje për anonimat (mos identifikim).

V TRANSGJINIA

Transgjinor do të thotë që seksi i një njeriu nuk korrespondon me mënyrën se si ndjehet ose sillet dhe për këtë njerëzit zgjedhin ti nënshtrohen ndërhyrjeve kirurgjikale për të ndryshuar gjininë e tyre.

Ka forma të ndryshme të transgjinisë:

Disa njerëz kombinojnë karakteristikat e burrave me të grave.

Ata e identifikojnë veten si burrë dhe si grua ose si asnjë prej tyre.

Disa persona transgjinorë e identifikojnë ndonjëherë veten si burrë dhe ndonjëherë si grua.

Të tjerët sillen dhe vishen si seksi tjetër.

SHËNIME DHE SUGJERIME PËR GAZETARËT

- ✓ Tregoni ndjeshmëri ndaj historive të tilla
- ✓ Historitë personale të individëve kthehen menjëherë në video virale në platformat sociale
- ✓ Është e nevojshme të përdoret terminologjia e duhur
- ✓ Personi duhet të referohet me përemrat e përzgjedhur sipas tij/saj, përndryshe konsiderohet diskriminim

VI

MARTESAT NË MOSHË TË HERSHME DHE LINDJA E FËMIJËS

Martesa e hershme ose e thënë ndryshe martesa e fëmijëve është bashkimi zyrtar ose jo i dy personave, kur të paktën një prej tyre është nën 18 vjeç.

Martesat e fëmijëve duhet të konsiderohen si një shkelje e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të fëmijës. Normalt e **martesës së fëmijëve** janë të ulëta në Shqipëri, por ato janë gjetur si praktika në komunitetin e romëve, si dhe në disa komunitete të izoluara rurale. **Martesa e fëmijëve** është një fenomen social që prek vajzat dhe djemtë në mënyra të ndryshme. Pasi martohen, si djemtë, edhe vajzat shpesh detyrohen të punojnë kryesisht në punë fizike për të përballuar kostot e jetesës duke hequr dorë dhe nga arsimit pasi përgjegjësitë e familjes i tejkalojnë anagzhimet e tjera qofshin këto edhe arsimore.

Ligji Kuadër për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës përputhet me Konventën e OKB mbi të Drejtat e Fëmijës (që Shqipëria ka ratifikuar në vitin 1992) dhe e përcakton fëmijën si "**çdo person i lindur gjallë**", i cili është nën moshën 18 vjeç.

SHËNIME DHE SUGJERIME PËR GAZETARËT

- ✓ Kur flisni për **martesat e hershme** dhe problematikat që lidhen me shëndetin riprodhues në tërësi shpjegojuni adoleshentëve që ju jeni gazetarë dhe se ku qëndron qëllimi i artikullit tuaj dhe sa të dhëna do të përdorni në atë artikull, pasi shumica e tyre nuk e dinë rëndësinë e të folurit me një gazetar apo e të folurit publikisht.



QENDRA SHQIPTARE PER POPULLSINE DHE ZHVILLIMIN
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT

FJALORTH **SHËNDETI SEKSUAL DHE RIPRODHUES**

Aborti Mjekësor– Ndërprerja e shtatzënisé, heqja e embrionit ose fetuesit para se ai të mbijetojë jashtë mitrës. Në kontekstet mjekësore, ai quhet abort i induktuar.

Aborti Spontan- Rasti kur njeriu pëson një abort të pavullnetshëm ose lindje të vdekur.

Adoleshent – Person i moshës nga 10 në 19 vjeç.

Fëmijë – Individ që nuk e ka mbushur moshën 18 vjeç.

Abuzimi i të miturve/fëmijëve - Keqtrajtimi i fëmijëve, referohet në media edhe si abuzimi dhe neglizhimi i fëmijëve, përfshin të gjitha format e keqtrajtimit fizik dhe emocional, abuzimin seksual, shfrytëzimin që pasohet me dëmtime fizike emocionale dhe pasoja negative në shëndetin, zhvillimin dhe dinjitetin e fëmijës. Terminologjia e përdorur në media është abuzimi fizik, abuzimi seksual, neglizhenca dhe trajtimi i pakujdeshëm, abuzimi emocional dhe shfrytëzimi.

Martesat e hershme - Quhet e tillë kur një person (ose të dy) nën moshën 18 vjeç vendos të martohet, të bashkëjetojë ose të lidhë marrëveshje për këtë qëllim.

Kontraceptivë - Produkte farmaceutike të krijuara për të parandaluar shtatzënинë duke ndërhyrë në procesin normal të ovulacionit, fekondimit dhe implantimit.

Kontraceptivë efektiv - Termi i referohet grave që mbeten shtatzënë duke përdorur një metodë e veçantë kontraceptive në sugjerimin dhe ndjekjen e mjekëve.

Kontraceptivët e urgjencës - Pilula që përdorin gratë për parandalimin e shtatëzanisë, pasi kanë kryer marrëdhënie seksuale të pambrojtura ose kanë përdorur një metodë kontraceptive që nuk ka arritur të parandalojë shtatzëninë.

Diskriminimi - Paragjykimi dhe trajtimi në mënyrë të pafavorshëm i një personi për shkak të identitetit, racës, fesë ose gjinisë.

Planifikimi Familjar - Mënyrë për të kontrolluar fertilitetin që çiftet të kenë numrin e fëmijëve që dëshirojnë dhe në kohën kur dëshirojnë.

Fertiliteti - Aftësia për të mbetur shtatzënë në aktivitet normal seksual dhe për të lindur fëmijë.

Fistula obstetrike - Një nga dëmtimet më serioze dhe tragjike që mund të ndodhin gjatë lindjes. Kjo është një problematikë shëndetësore ndërmjet kanalit të lindjes dhe fshikëzës ose rektumit të shkaktuar nga puna e zgjatur dhe pa trajtim.

Martesa e detyruar - Bashkim i dy individëve që ndodh pa pëlqimin e plotë dhe pa vendosmërinë e tyre.

Gjyntimi/prerja gjenitale femërore - Përfshin të gjitha procedurat që përfshijnë në mënyrë totale ose të pjesshme heqjen e organeve gjenitale të femrës ose ndonjë dëmtim në organin gjenital femëror për arsyen e mjekësore.

Gjinia - Termi i referohet roleve dhe përgjegjësive të përcaktuara në shoqëri të burrave dhe grave, djemve dhe vajzave.

Dhuna me bazë gjinore - Një formë dhune që shënjestron gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, bazuar në gjininë e tyre.

Barazia Gjinore - Trajtimi i barabartë i grave, burrave, vajzave dhe djemve në ligj dhe politika dhe aksesi i barabartë në burime dhe shërbime brenda familjeve, komuniteteve dhe shoqërisë në përgjithësi.

Diskriminimi gjinor - I referohet çdo dallimi, përjashtimi ose kufizimi të bërë mbi bazat e roleve dhe normave gjinore të ndërtuara në shoqëri që e pengojnë një person të gëzojë plotësisht të drejtat e njeriut.

Stereotipet gjinore - Mendimet dhe ndarjet e roleve qe janë aq të rrënjosura në ndërgjegjen tonë dhe i lidhim automatikisht me sjellje dhe punë sipas gjinisë.

Paragjykimi gjinor - Kjo i referohet paragjykimit të bazuar në gjini; supozime të shprehura pa arsyе dhe të pafavorshme.

Integrimi gjinor - Përfshirja e çështjeve gjinore në analizën, formulimin, zbatimin, monitorimin e strategjive, programeve, projekteve, politikave dhe aktiviteteve në adresimin e pabarazive midis grave dhe burrave.

Shëndeti - Gjendje e mirëqenies së plotë fizike, mendore dhe sociale dhe jo thjesht mungesë të sëmundjes ose pamundësisë fizike.

Steriliteti/ Infertiliteti - Një individ nuk është në gjendje të lindë një fëmijë, qoftë për shkak të pamundësisë për mbetur shtatzënë ose pamundësia për të çuar një shtatzëni në një lindje të gjallë.

Vdekje amtare - Humbja e jetës që i ndodh një gruaje që është shtatzënë ose brenda 42 ditëve të ndërprerjes së shtatzënisë, pavarësisht nga kohëzgjatja dhe vendi i shtatzënisë ose

Kujdesi pas abortit - Trajtimi dhe mbështetja fizike, mjekësore, sociale dhe psikologjike i jepet një personi pas një aborti.

Përdhunimi - Marrëdhënie seksuale kundër vullnetit të një personi, me forcë, nën kërcënim, pa pëlqimin e tij dhe akt i paligjshëm.

Shëndeti riprodhues - Kjo është një gjendje e mirëqenies së plotë fizike, mendore dhe sociale dhe jo thjesht mungesa e sëmundjes ose dobësisë, në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sistemin riprodhues, funksionet dhe proceset.

Seksi - Karakteristikave biologjike që përcaktojnë njerëzit si femra apo meshkuj. Këto karakteristika biologjike nuk përjashtojnë njëra-tjetrën pasi ka individë që posedojnë të dyja për shkak të ndërhyrjeve të tyre në gjini, por në kushte natyrale këto karakteristika priren t'i dallojnë njerëzit si meshkuj dhe femra.

Dhunë seksuale - Akt fizik i dhunshëm, i paligjshëm që përfshin përdhunim, incest ose ndonjë vepër tjetër e parashikuar në ligj.

Shëndeti Seksual - Një gjendje e mirëqenies fizike, emocionale, mendore dhe sociale në lidhje me seksualitetin. Shëndeti seksual përfshin të drejtat seksuale të gjithë personave. Të drejta këto që duhet të respektohen, mbrohen dhe plotësohen.

Infekzionet seksualisht të transmetueshme (IST) - Infeksione që transmetohen përmes aktivitetit seksual me një partner të infektuar.

Aborti i pasigurt - Procedurë për ndërprerjen e shtatzënisë në një mjeshtëri që nuk është në përputhje me standarde mjekësore.

Shtatzënia e padëshiruar - Shtatzëni e padëshiruar, e ndodhur në kushtet kur nëna nuk dëshiron të ketë asnjë fëmijë ose nuk dëshiron më shumë fëmijë.

Nevoja e paplotësuar për planifikim familjar - Kjo i referohet përqindjes së grave në moshë riprodhuese, të martuara ose në bashkëjetesë, të cilat duan të ndalojnë ose vonojnë lindjen e fëmijëve por nuk përdorin asnjë metodë kontracepsioni.

Rreziku i vdekjes gjatë gjithë jetës së grave - Ky është rreziku i humbjes së jetës së një gruaje nga shtatzënia ose lindja e fëmijës gjatë jetës së saj.